VENDIM
Nr. 183, datë 19.4.1997

PËR PROKURIM TË DREJTPËRDREJTË

Me propozimin e Ministrisë së Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të autorizojë Ministrinë e Brendshme që shërbimet e riparimeve dhe të mirëmbajtjes së teknikës që disponojnë organet e repartet e saj, t'i prokurojë drejtpërdrejt me shoqërinë tregtare "Ofiçina auto e rendit publik".

2. Të autorizojë Ministrinë e Brendshme që për vënien në gatishmëri të teknikës speciale që disponon në sektorin auto , të prokurojë drejtpërdrejt me firmat prodhuese.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet gjer më 30.6.1997.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino